



Java Kundër
KORRUPSIONIT
3-9 DHJETOR 2017

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe Agjencia Kosovare e Akreditimit: Amnistues të Shkelësve të Ligjit?



#bashkeendreqim #UnitedAgainstCorruption #KS

Koalicioni i OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" përbëhet nga:
IKD, GLPS, ÇOHU, GAP, INPO, KIPRED dhe COLUMBUS



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

INPO

INSTITUTI
PËR STUDIME
GAP



QENDRA PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

COLUMBUS



ÇOHU!

KIPRED

Përgatitur nga: Blend Zyrapi

Editorë: Lulzim Peci dhe Ariana Qosaj-Mustafa



Ky projekt është mbështetur përmes grantit nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Prishtinë. Mendimet, të gjeturat dhe konkluzionet apo rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe domosdoshmërisht nuk reflektojnë ato të Departamentit të Shtetit.

Shkurtesat:

MASHT- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

AKA- Agjencia Kosovare e Akreditimit

KSHC- Këshilli Shtetëror i Cilësisë

IPAL- Institucionet Publike të Arsimit të Lartë

IAL- Institucionet e Arsimit të Lartë

BPrAl- Bartësit Privat të Arsimit të Lartë

SMIAL- Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë

UA- Udhëzim Administrativ

Përmbajtja

I. Hyrje	5
II. “Amnistimi” i veprave penale në Arsimin e Lartë të Kosovës.....	6
III. Toleranca ndaj shkeljeve të ligjit dhe manipulimit me numrin e studentëve nga BPrAL-të8	

I. Hyrje

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) dhe Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) janë rregullatorët kyç të Arsimit të Lartë në Kosovë. AKA është përgjegjëse për akreditimin dhe ri-akreditimin e bartësve të arsimit të lartë në Kosovë, ndërsa MASHT është përgjegjëse për licencimin e bartësve të arsimit të lartë në Kosovë.¹

Ky raport i shkurtër shqyrton “amnistimin” nga ndjekja penale që Agjencia Kosovare e Akreditimit, i bëri manipulimeve nga një numër i stafit akademik nga rajoni të angazhuar nga disa prej bartësve privat të arsimit të lartë (BPrAL), mos-respektimin e normave ligjore në procesin e grumbullimit si dhe monitorimin e të dhënave në arsimin e lartë nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT-i), si dhe futjen e këtyre të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL) për vitin 2016 dhe 2017.

Në pjesën e parë të raportit do të trajtohet rasti i 48 profesorëve si dhe BPrAL-ve që kanë paraqitur deklarime të rreme – gjegjësisht të falsifikuara në AKA. Ndërsa, në pjesën e dytë do të trajtohet mos zbatimi i legjislacionit në fuqi nga BPrAL në lidhje me dorëzimin e të dhënave në Ministrinë e Arsimit për studentët e pranuar si dhe tejkalimin e kuotave të studentëve të regjistruar nga këto institucione.

¹ Ligji Nr. 04/L-037, Ligji për arsimin e lartë në Kosovë, neni 11, paragrafi 3, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

II. “Amnistimi” i veprave penale në Arsimin e Lartë të Kosovës

Njëra nga të gjeturat për manipulimet në procesin e akreditimit nga disa nga BprAL dhe stafi akademik nga rajoni, u bënë publike në takimin e 22 shtator 2017 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), dhe ate tre ditë para shkarkimit të përbërjes së tij nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.² Me këtë rast, KSHC-ja njoftoi si vijon:

“Deri më tani, AKA ka identifikuar 82 persona, shtetas të huaj, me gradë akademike Doktor Shkence (PhD) të cilët janë të paraqitur në Kosovë, si staf i rregullt akademik, se kanë marrëdhënie të rregullt të punës edhe në shtetet e tyre të origjinës, ani pse të njëjtit më parë kanë sjellë dëshmi për mos-angazhimin e tyre në marrëdhënie pune në vendet e tyre të origjinës.

...Deri në këtë fazë, AKA në kërkesën për informata lidhur me angazhimin e këtij stafi akademik, ka pranuar përgjigje për 65 persona dhe është në pritje të përgjigjes edhe për 17 persona të tjerë. Nga përgjigjet zyrtare që AKA ka pranuar rezulton se 48 persona të paraqitur si staf i rregullt akademik në IAL në Republikën e Kosovës, në të njëjtën kohë kanë marrëdhënie të rregullt pune edhe në vendet e tyre të origjinës, jashtë Kosovës.

...AKA ka vërtetuar se 48 persona kanë dorëzuar deklaram të rremë në AKA për qëllime të akreditimit të programeve të studimit dhe kjo paraqet shkelje serioze të dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës. Për më tepër, ky deklaram i rremë përbën shkelje të rëndë të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë, meqenëse AKA në këtë mënyrë ka bërë akreditimin e programeve të studimit bazuar në dëshmi dhe informata të rrejshme.

AKA ka njoftuar IAL-të të cilat janë afektuar nga dorëzimi i deklarimeve të rrejshme nga stafi i tyre akademik me nënshtetësi të huaj dhe ju ka dhënë afat shtesë për largimin e ketyre personave nga listat e stafit akademik. Megjithatë, për IAL-të të cilat nuk kanë arritur të bëjnë zëvendësimet e nevojshme sipas kërkesës së AKA-së, KSHC ka marrë vendim për tërheqjen e akreditimit të 5 programeve të studimit në tri institucione të arsimit të lartë....”

² Mbledhja e Këshillit Shtetërorë të Cilësisë, mbajtur me 22 shtator 2017, <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/homepage-2/98-kaa-articles-2/lajmet/376-kshc53>.

Për më tepër, gjatë procesit të verifikimit të tyre, përmes intervistave me disa nga stafi akademik nga rajoni të deklaruar si të tillë nga disa IAL, është mësuar se ata nuk ia kanë idenë se si kanë mbërritur dokumentet e tyre në Kosovë.”³

Megjithatë, derisa AKA e ka bërë këtë verifikim më se të domosdoshëm, ai nuk i ka bërë transparent emrat e “stafit akademik” që kanë dhënë deklaramë të rrejshme, si dhe IAL-të të involvuara në këto manipulime.

Mirëpo, problemi madhor qëndron në atë se nga e nxjerr autoritetin e vet KSHC-ja për t’i amnistuar deklaramet e rrejshme të këtyre personave si dhe IAL-të e përfshira në këto manipulime, për t’i amnistuar nga përgjegjësia penale dhe mos i paraqitur në Prokurorinë e Shtetit. Në vend të kësaj, IAL-ve të tilla vetëm ju është dhënë afat shtesë për largimin e këtyre personave nga listat e tyre të stafit akademik, ndërsa tri prej tyre që kanë dështuar, u janë tërhequr akreditimet për pesë programe studimore.

Përgjegjësia penale është shumë e qartë pasi Neni 335, Neni 386, Neni 398 dhe Neni 399 nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës aktet e tilla i cilëson si vepër penale të cilat dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre vite.⁴ Në këtë rast KSHC-ja ishte e obliguar ta raportonte rastin në Prokurori, gjë që edhe u konfirmua edhe ish-ushtresja e detyrës së Drejtorës së AKA-së⁵, gjersa, në vend të në vend të ndërmarrjes së këtij veprimi ligjor, KSHC-ja vendosi t’i publikojë në ueb faqe të dhënat, dhe atë vetëm në formë numerike, pa emra të individëve apo institucioneve dyshuar për kryerje të veprave penale.

Këto vepra penale nuk amnistohen, andaj AKA ose do të duhet vetë t’i paraqes dyshimet e tilla për kryerje të veprave penale në Prokurori, apo Prokuroria duhet të bëjë hapje të menjëhershme të hetimeve si ndaj kryesve të dyshuar të këtyre veprave penale, po ashtu dhe ndaj AKA-së për

³ Intervistë, 14 nëntor 2017, me ish ushtresen e detyrës së drejtorit në AKA-së znj. Fortuna Mehmet si dhe Bekim Samadragja i caktuar nga MASHTI në muajin shtator ushtres detyre i drejtorit në AKA.

⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 04/L-082, neni 335 paragrafi 1- Veprat Penale lidhur me Mashtrimin 1, Neni 386 paragrafi 1.7- Veprat Penale lidhur me Moslajmërimi i Veprave Penale apo Kryesve të tyre , Neni 398 paragrafi 1-Veprat Penale lidhur me Falsifikimin e Dokumenteve si dhe neni 399 paragrafi 1.1-Veprat Penale lidhur me Rastet e Posaçme të Falsifikimit të Dokumenteve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>

⁵ Intervistë, me datë 14 nëntor 2017, me ish ushtresen e detyrës së drejtorit në AKA-së znj. Fortuna Mehmet si dhe Bekim Samadragja i caktuar nga MASHTI në muajin shtator ushtres detyre i drejtorit në AKA.

mos paraqitjen e tyre.

III. Toleranca ndaj shkeljeve të ligjit dhe manipulimit me numrin e studentëve nga BPrAL-të

Në bazë të Udhëzimit Administrativ 12/2016 për Menaxhimin edhe Funkcionalizimin e Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL), MASHT-i është përgjegjës i sistemit SMIAL si dhe përgjegjës në menaxhimin dhe grumbullimin e të dhënave nga bartësit e arsimit të lartë në Kosovë.⁶

Para hyrjes në fuqi të UA 12/2016 për menaxhimin dhe grumbullimin e të dhënave të arsimit të lartë, MASHT-i është udhëhequr në punën e vet përmes disa Udhëzimeve Administrative nga vitet e kaluara. Në muajin maj të vitit 2014 MASHT- kishte nxjerrë UA 20/2014 për librat amëz të studentëve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.⁷ Ky UA parashikonte që çdo institucion i arsimit të lartë ishte i obliguar që të plotësonte dhe të ruante librat amëz të studentëve,⁸ të cilat duhet të plotësoheshin dhe të dërgoheshin në MASHT në formë elektronike në fillim të vitit akademik. Me UA 20/2014, ishte përcaktuar edhe afati kohor për studimet themelore më së largu me 15 tetor, ndërsa për studimet master dhe doktoratë më së largu deri me 15 nëntor.⁹ Dorëzimi në MASHT i kopjes fizike të origjinalit të librit amëz kishte përcaktuar afatin kohorë 20 tetor për studime themelore dhe 20 nëntor për studime master dhe doktoratë.¹⁰ Ndërsa në po të njëjtin vit dhe atë pas pesë muajve në tetor 2014, MASHT-i shfuqizon UA 12/2014 dhe nxjerr një udhëzim administrativ të ri 33/2014.¹¹ Mirëpo Udhëzimi Administrativ 33/2014 është i njëjti me udhëzimin e shfuqizuar administrativ 12/2014 dhe si i tillë nuk ka

⁶ Udhëzimi Administrativ 12/2016, për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, Neni 5 paragrafi 1.1, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf> , UA ka hyre ne fuqi me 06 qershor 2016

⁷ Udhëzimi administrativ 20/2014, libri amëz të studentëve të institucioneve të arsimit të lartë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10188> (qasur 23 nëntor 2017)

⁸ Po aty, neni 2 paragrafi 1 dhe 2,

⁹ Po aty, neni 3 paragrafi 1 dhe 2,

¹⁰ Po aty, neni 3 paragrafi 3,

¹¹ Udhëzimi administrative 33/2014, libri amëz të studentëve të institucioneve të arsimit të lartë, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-nr-33-2014.pdf> (qasur 23 nëntor 2017)

pësuar ndonjë plotësim apo ndryshim.¹² Në këto dy udhëzime administrative, MASHT-i nuk ka paraparë asnjë masë ligjore për mos-zbatimin e tyre nga institucionet e arsimit të lartë.

Në anën tjetër, në vitin 2016 MASHT ka nxjerrur Udhëzimin Administrativ 12/2016 për themelimin dhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave të arsimit të lartë - sistemi SMIAL,¹³ i cili rregullon grumbullimin dhe monitorimin e të dhënave për IAL-të në mënyrë të digjitalizuar.¹⁴ Poashtu, ky udhëzim administrativ ka përcaktuar edhe afatet për raportimin e të dhënave nga IAL-të.¹⁵ Për ciklin e studimeve baçelor, IAL obligohen që të dhënat e studentëve ti raportojnë deri me 30 shtator, për master 31 tetor, dhe për doktoratës 31 tetor dhe 15 mars.¹⁶ Në këtë UA është paraparë edhe masa ligjore e tërheqjes së licencës, në rast se IAL-të nuk raportojnë të dhënat në afatet e përcaktuara.¹⁷

Mirëpo, vetëm një vit pas nxjerrjes së UA 12/2016, MASHT-i bënë plotësimin dhe ndryshimin e tij dhe ate në pjesët ku përcaktohen afatet kohore të raportimit të të dhënave, si dhe tek pjesa ku janë paraparë masat ligjore. Për ciklin Baçelor, afati kohor për dorëzimin e të dhënave është shtyer deri më 15 nëntor,¹⁸ ndërsa për nivelin master është shtyer më 20 nëntor.¹⁹ Ndryshime kishte edhe tek masa ligjore, me ç'rast u hoq masa tërheqjes së licencës për ato institucione të cilët nuk raportojnë të dhënat sipas afateve të caktuara,²⁰ dhe ajo u zëvendësua me mos lejimin e futjes dhe përditësimin e të dhënave në sistemin SMIAL, në rast se raportojnë jashtë afateve kohore.²¹

¹² Shiko udhëzimin administrativ 20/2014, libri amëz të studentëve të institucioneve të arsimit të lartë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10188>, si dhe UA 33/2014, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-nr-33-2014.pdf>

¹³ Udhëzimi administrative 12/2016, për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf> (qasur 23 nëntor 2017)

¹⁴ Po aty, neni 3 paragrafi 1.2

¹⁵ Po aty, neni 6 paragrafi 1.2

¹⁶ Po aty, neni 7 paragrafi 1,2,3

¹⁷ Po aty, neni 12

¹⁸ Udhëzimi administrative 11/2017, Për plotësim dhe ndryshim të UA 12/2016 për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, Neni 2 paragrafi 1 dhe 2, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf>, UA ka hyre ne fuqi me 25 gusht 2017

¹⁹ Po aty,

²⁰ Udhëzimi administrative 12/2016, neni 12, për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf> (qasur 23 nëntor 2016)

²¹ Udhëzimi administrative 11/2017, Për plotësim dhe ndryshim të UA 12/2016 për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, Neni 2 paragrafi 4, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf>, UA ka hyre ne fuqi me 25 gusht 2017

Kjo heqje e masës së tërheqjes së licencave të IAL-të në rast të shkeljes së normave ligjore për kohën e raportimit dhe numrin e studentëve të regjistruar, hapë rrugë parregullsive madhore në administrimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe ate sidomos në sektorin privat, pasi praktikisht zbatimi i normave ligjore nga IAL-të mbetet në vullnetin e mirë të tyre.

Me këtë rast duhet theksuar, se përkundër faktit që udhëzimet administrative të lartpërmendura, përcaktojnë afate kohore për dorëzimin e të dhënave të studentëve të pranuar për vitet akademike nga IAL, shumica e kolegje private nuk kanë zbatuar udhëzimet e lartpërmendura administrative, si në kohën kur ishin të detyruar për ti dorëzuar librat amëz, ashtu edhe tani kur dorëzimi i tyre bëhet në formë elektronike.

Këtë fakt e konfirmon edhe ish ushtruesja e detyrës së drejtorit të AKA-së znj. Furtuna Mehmeti, e cila thekson se “kemi informatat jo zyrtare se institucionet i kanë vonuar librat amëz në MASHT, dhe se kjo krijon mundësi për BPrAL të regjistrojnë studentë edhe pas afatit të përcaktuar.”²² Për më tepër, MASHT cek se deri më tani jo të gjitha kolegjet i kanë dorëzuar të dhënat në SMIAL.²³ Mirëpo, afati kohor i përcaktuar në UA për dorëzimin e të dhënave në sistemin SMIAL tanimë ka kaluar. Për ta vërtetuar se cilat BprAL i kanë dorëzuar të dhënat në sistemin SMILE, dhe cilat kanë dështuar, KIPRED-i përmes postës elektronike i kërkoi Departamentit të Arsimit të Lartë të MASHT-it²⁴ informata mirëpo për këtë nuk ka marrë përgjigje.

Duke patur parasysh faktin që në vitin 2017, AKA ka kufizuar numrin e studentëve që mund të regjistrojnë BPrAL në programet e akredituara,²⁵ mos-raportimi i këtyre të dhënave si nga MASHT-i ashtu edhe nga BprAL-të, ngrisin dyshime të drejtëpërdrejta se BPrAL nuk po i përmbahen këtyre kufizimeve të kuotave të studentëve që mund ti regjistrojnë në programet e tyre. Një rast i tillë i keqpërdorimeve është ngritur edhe nga ish anëtarët e KSHC-së që

²² Intervistë, mbajtur më 14 nëntor 2017, me ish ushtruesen e detyrës së drejtorit në AKA znj. Fortuna Mehmet si dhe Bekim Samadragja i caktuar nga MASHTI në muajin shtator ushtrues detyre i drejtorit në AKA.

²³ Intervista me drejtoreshën e departamentit të arsimit të lartë në MASHT znj. Drita Kadriu, e mbajtur me datë 17 nëntor 2017, në Ministrinë e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

²⁴ Kërkesa është dërguar përmes postës elektronike me 17 nëntor 2017, drejtorisë së arsimit të lartë në Ministrinë e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

²⁵ Intervistë, 14 nëntor 2017, me ish ushtruesen e detyrës së drejtorit në AKA-së znj. Fortuna Mehmet si dhe Bekim Samadragja i caktuar nga MASHTI në muajin shtator ushtrues detyre i drejtorit në AKA

deklarojnë se “Kolegji AAB vetëm në infermieri për një vit ka regjistruar mbi një mijë studentë!
Rregullsi se jo mahi!”.²⁶

Në lidhje me këtë çështje, MASHT thekson se si për mos dërgimin e të dhënave, ashtu edhe tejkalimi i numrit të lejuar të studentëve të regjistruar, përgjegjësia bie mbi institucionet private “BPrAL, nëse ju mbetën studentët jashtë sistemit SMIAL”²⁷. Mirëpo, në raste të tilla, përgjegjësia është e BPrAL-ve për mos zbatimin e ligjit, ndërsa përgjegjësia është MASHT-it për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, si dhe për të evituar keqpërdorimin e studentëve, të cilët në mënyrë të paligjshme janë regjistruar nga BPrAL-të. Bazuar në deklarin e mëhershëm të Dr. Lulzim Rakës për tejkalimin e numrit të studentëve të regjistruar në drejtimin e infermierisë të AAB-së²⁸, mund të konkludojmë, se vetëm në vitin 2016 ky BPrAL ka pasur përfitime enorme të paligjshme, gjersa në anën tjetër studentë të regjistruar jashtë normave të lejuara nga AKA-ja nuk mund të konsiderohen të ligjshëm. Ky rast me siguri nuk është i izoluar, dhe ironia qëndron në atë se përkundër këtyre fakteve apo dyshimeve të evidentuara nga vetë institucionet rregullative të arsimit të lartë, BPrAL-të nuk sanksionohen, dhe në vend të kësaj ato realizojnë fitime të kundërligjshme, duke i shndërruar në viktima studentët e regjistruar përtej kuotave të lejuara.

Për më tepër, Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) e cila është përgjegjëse për inspektimin e bartësve të arsimit të lartë, nuk ka kryer kontrollat periodike mbi cilësinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë apo vlerësimet periodike mbi cilësinë e programeve të ofruara nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë.²⁹ Kompetencat e AKA-së lidhur me kontrollat dhe vlerësimet periodike nuk janë zbatuar në praktikë dhe kjo e rritë edhe më tutje potencialin e keqpërdorimeve nga BPrAL-të.

²⁶ Cituar nga Insajderi: ANËTARI I SHKARKUAR I BORDIT TË AKK – KRYEMINISTRIT: JU RRËFEJ “PARREGULLËSITË SERIOZE”, Dr. Lulzim Raka, 25 shtator 2017, <http://www.insajderi.com/anetari-shkarkuar-bordit-te-akk-kryeministr-it-ju-rrefej-parregullesite-serioze/> (qasur me 25 nëntor 2017)

²⁷ Intervista me drejtoreshën e departamentit të arsimit të lartë në MASHT znj. Drita Kadriu, e mbajtur me datë 17 nëntor 2017, në Ministrinë e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

²⁸ Cituar nga Insajderi: ANËTARI I SHKARKUAR I BORDIT TË AKK – KRYEMINISTRIT: JU RRËFEJ “PARREGULLËSITË SERIOZE”, Dr. Lulzim Raka, 25 shtator 2017, <http://www.insajderi.com/anetari-shkarkuar-bordit-te-akk-kryeministr-it-ju-rrefej-parregullesite-serioze/> (qasur me 25 nëntor 2017)

²⁹ Ligji Nr. 04/L-037, Ligji për arsimin e lartë në Kosovë, neni 7, paragrafi 2.2 dhe 2.3, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

Në lidhje me këtë, ish ushtruesja e detyrës së drejtorit në AKA, znj. Fortuna Mehmeti, vë në pah faktin, se deri me tash Agjencia nuk ka bërë asnjëherë kontroll periodik në terren të cilësisë së BprAL edhe pse një gjë e tillë është e paraparë me ligj³⁰ dhe ato kanë qenë të kufizuara vetëm në rastet e akreditimit të programeve të tyre studimore. Në bazë të saj, mosrealizimi i kontrolleve të rregullta/periodike është pasojë e mos ekzistimit të metodologjisë së monitorimit të rregullt si dhe mungesës së resurseve³¹.

Përgjegjës për inspektim dhe monitorim të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) është edhe Inspektorati i Arsimit në MASHT, i cili në bazë të ligjit ka për detyrë për inspektimin e rregullt të bartësve të arsimit të lartë.³² KIPRED përmes postes elektronike ka kërkuar informacione nga Inspektorati i Arsimit në lidhje me atë nëse ka inspektime të rregullta për bartësit e arsimit të lartë, dhe për këtë nuk ka marrur përgjigje. Në këtë rast, mungesa e transparencës vetvetiu ngritë dyshimet që inspektimet e rregullta nuk kryhen me rregull nga ky institucion.³³

Një gjendje e tillë a amnistisë, deri në nivelin e veprave penale, ndaj bartësve të arsimit të lartë në Kosovë, mos-transparenca publike, si dhe moszbatimi i kontrollit dhe inspektimeve nga MASHT-it dhe AKA, ndaj institucioneve private të arsimit dhe stafit të tyre, padyshim se “ushqen” parregullsitë si dhe korrupsionin në arsimin e lartë. Me këtë rast, pasojat direkte do t'i bartin mbi supet e tyre më së shumti studentët, dhe atë si me rastin e regjistrimit të paligjshëm tyre ashtu edhe me rastin e tërheqjes së akreditimeve të programeve studimore.

³⁰ Intervistë, 14 nëntor 2017, me ish ushtruesen e detyrës së drejtorit në AKA znj. Fortuna Mehmet si dhe Bekim Samadragja i caktuar nga MASHTI në muajin shtator ushtrues detyre i drejtorit në AKA.

³¹ Po aty,

³² Ligji Nr. 04/L-037, Ligji për inspeksionin e arsimit në Kosovë, neni 4 paragrafi 4.1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2453>

³³ Kërkesa është dërguar përmes postës elektronike me 22 nëntor 2017, Drejtor i Inspektoratit të Arsimit z.Defrim Gashi dhe znj. Mehreme Grushti asistente administrative pranë inspektoratit.